



Dokument i Politikave

**Të kuptojmë UNDROP
- Çfarë do të thotë për Shqipërinë?**

DOKUMENT I POLITIKAVE

Të kuptojmë UNDROP - Çfarë do të thotë për Shqipërinë?

Autorë:

Evelina Azizaj, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

Rozeta Gradeci, COSPE, Shqipëri

Layout: Ema Ismaili

© Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural, 2026.

Layout-i i këtij publikimi është përgatitur me mbështetjen financiare të WE Effect dhe Qeverisë suedeze, në kuadër të projektit *“Mbështetje për zhvillimin rural gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në Shqipëri”*, i cili zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural gjatë periudhës 2026-2028. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ANRD-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e WE Effect apo të Qeverisë suedeze.



1. Hyrje

Komunitetet rurale në Shqipëri vijnë të përballen me sfida ekonomike, sociale dhe mjedisore, ndërsa vendi avancon në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, bujqësia dhe zhvillimi rural mbeten ndër prioritetet kryesore për forcimin e sigurisë ushqimore, zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e balancuar territorial. Arritja e këtyre objektivave kërkon politika që mbështesin jo vetëm konkurrueshmërinë e sektorit, por edhe jetesën dhe mirëqenien e njerëzve që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale.

Fermerët familjarë, blegtorët, prodhuesit e vegjël dhe njerëzit e tjerë që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale japin një kontribut të rëndësishëm në prodhimin e ushqimit, menaxhimin e burimeve natyrore, ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e territoreve rurale. Mbështetja e tyre dhe krijimi i perspektivave të qëndrueshme që mundësojnë kontributin e tyre aktiv në zhvillimin e vendit janë prioritare për të ardhmen e Shqipërisë rurale.

Në këtë kuadër, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fermerëve të vegjël dhe Personave të Tjerë që Punojnë në Zonat Rurale (UNDROP) ofron një kornizë referimi që pasuron dialogun mbi zhvillimin rural. Ajo promovon një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, duke vendosur në qendër njerëzit që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale dhe duke nxitur reflektimin mbi mënyrën se si politikat publike ndikojnë jetesën dhe mirëqenien e tyre.

Për Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), prezantimi i UNDROP është një vazhdimësi e angazhimit për zhvillim rural gjithëpërfshirës, me pjesëmarrje dhe të qëndrueshëm. ANRD, përmes nismave si Parlamenti Rural Shqiptar, Qendra e Rinisë Rurale, Pro-Grave Rurale, promovimit të qasjes LEADER/CLLD dhe mbështetjes për bujqësinë familjare, ka kontribuar në forcimin e dialogut ndërmjet komuniteteve rurale, institucioneve publike dhe partnerëve të zhvillimit.

Ky publikim synon të prezantojë UNDROP dhe rëndësinë e tij për vendin tonë. Dokumenti shpjegon parimet dhe të drejtat kryesore të njohura nga Deklarata, lidhjen e tyre me prioritetet e zhvillimit rural në vend dhe veçon qeverisjen e tokës bujqësore si një temë me rëndësi për debatin publik. Qëllimi i tij nuk është të ofrojë interpretime ligjore apo rekomandime politike, por të nxisë dialogun dhe reflektimin mbi mënyrën se si parimet e UNDROP mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të zonave rurale.

2. Çfarë është UNDROP?

UNDROP u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në dhjetor 2018. Kjo Deklaratë është instrumenti i parë ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që ka në fokusin e vet fermerët familjarë dhe prodhuesit e vegjël si dhe personat e tjerë që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale, duke njohur kontributin e tyre përcaktues në prodhimin e ushqimit, ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

UNDROP nuk është një traktat ndërkombëtar me fuqi detyruese. Megjithatë, ajo përfaqëson një kuadër të rëndësishëm referimi, të dakordësuar në nivel ndërkombëtar, që mund të orientojë hartimin e politikave publike, përmirësimin e legjislacionit dhe zbatimin e detyrimeve ekzistuese në fushën e të drejtave të njeriut. UNDROP sistematizon të drejtat universale të njeriut dhe i interpreton ato në kontekstin e jetës dhe punës në zonat rurale, duke nxitur institucionet publike të marrin në konsideratë të drejtat, mirëqenien dhe dinjitetin e komuniteteve rurale gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

Zbatimi i UNDROP vijon të zhvillohet edhe në nivel ndërkombëtar. Në tetor 2023, Këshilli i të Drejtave të Njeriut i OKB-së krijoi Grupin e Punës për të Drejtat e fermerëve dhe personave të tjerë që punojnë në zonat rurale, të përbërë nga pesë ekspertë të pavarur. Ky mekanizëm përfaqëson një hap të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të UNDROP, duke krijuar një mekanizëm të posaçëm ndërkombëtar për monitorimin dhe promovimin e parimeve të Deklaratës. Mandati i tij përfshin promovimin dhe monitorimin e zbatimit të UNDROP, zhvillimin e vizitave në vende, hartimin e raporteve tematike dhe dialogun me shtetet, shoqëritë civile, organizatat e fermerëve dhe agjencitë e OKB-së. Mandati i Grupit të Punës do të shqyrtohet për rinovim gjatë sesionit të tetorit 2026 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.

3. Pse ka rëndësi UNDROP?

Miratimi i UNDROP u nxit dhe u mbështet nga një realitet i pamohueshëm: njerëzit që prodhojnë ushqimin dhe kujdesen për burimet natyrore janë shpesh ndër grupet më të cënueshme të shoqërisë. Në mbarë botën, fermerët familjarë dhe komunitetet e tjera rurale luajnë rol kryesor në garantimin e sigurisë ushqimore, ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e ekonomive rurale. Megjithatë, shumë prej tyre vazhdojnë të përballen me pasiguri mbi të drejtat e përdorimit dhe pronësisë së tokës, qasje të kufizuara në burime prodhuese, tregje dhe shërbime publike, si edhe me pasoja gjithnjë e më të dukshme të ndryshimeve klimatike.

UNDROP thekson se qëndrueshmëria e sistemeve ushqimore nuk varet vetëm nga prodhimi bujqësor, por edhe nga mbrojtja e të drejtave, mirëqenies dhe dinjitetit të njerëzve që prodhojnë ushqimin. Edhe pse realiteti i komuniteteve rurale në Shqipëri ndryshon nga ai i shumë vendeve që nxitën përgatitjen e UNDROP, një pjesë e sfidave që trajton Deklarata janë të pranishme edhe në vendin tonë. Bujqësia familjare, e cila përbën shtyllën kryesore të bujqësisë shqiptare, vazhdon të përballlet me sfida strukturore, si fragmentarizimi i tokës bujqësore, pasiguria mbi të drejtat e pronësisë dhe përdorimit të saj, plakja e popullsisë rurale, emigrimi dhe shpopullimi i fshatit, ndikimet e ndryshimeve klimatike, si dhe qasja e kufizuar në tregje, financim dhe inovacion.

Këto sfida janë tashmë pjesë e prioritetëve të politikave kombëtare, procesit të integritetit evropian dhe rekomandimeve të Parlamentit të IV Rural Shqiptar. Në këtë kontekst, UNDROP sjell një këndvështrim me në qendër njerëzit e komuniteteve rurale, që plotëson reformat ekzistuese duke nxitur politikëbërjen të vlerësojë se si politikat bujqësore dhe rurale ndikojnë në të drejtat, burimet e jetesës dhe mirëqenien e komuniteteve rurale.

4. Cilat të drejta njeh UNDROP?

UNDROP përmbledh në një kornizë të vetme të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore që lidhen drejtpërdrejt me jetën dhe punën e njerëzve në zonat rurale. Pra, si zbatohen të drejtat universale të njeriut në kontekstin e realitetit rural.

Tabela në vijim paraqet të drejtat që kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin rural në Shqipëri dhe mënyrën se si ato mund të kontribuojnë në forcimin e bujqësisë familjare, përmirësimin e qeverisjes së tokës bujqësore dhe ndërtimin e komuniteteve rurale më gjithëpërfshirëse dhe më rezistente.

Tabela 1. Të drejtat kryesore të njohura nga UNDROP

Tema	UNDROP njeh dhe promovon	Pse ka rëndësi?
Toka dhe burimet natyrore (Neni 5 – burimet natyrore; Neni 17- aksesimi në tokë; Neni 18 - mjedisi)	Të drejtën e njerëzve në zonat rurale për qasje të sigurt në tokë dhe burime natyrore.	Siguria mbi të drejtat e tokës nxit investimet, përdorimin e qëndrueshëm të tokës dhe krijon stabilitet afatgjatë për familjet rurale
Pjesëmarrja (Neni 10)	Të drejtën e komuniteteve rurale për të marrë pjesë në vendimmarrjen që ndikon jetën e tyre.	Politikat janë më efektive kur ndërtohen me pjesëmarrjen e komuniteteve.
Ushqimi (Neni 15)	Të drejtën për ushqim të mjaftueshëm dhe rolin e rëndësishëm të fermerëve në garantimin e sigurisë ushqimore.	Siguria ushqimore varet nga mbështetja për ata që prodhojnë ushqimin.
Farat (Neni 19)	Të drejtën e fermerëve për të ruajtur, përdorur, shkëmbyer dhe zhvilluar farat.	Diversiteti i farave kontribuon në ruajtjen e biodiversitetit, rrit rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbështet bujqësinë e qëndrueshme.
Uji dhe mjedisi (Neni 18 – mjedisi; Neni 21– uji i pijshëm dhe shërbimet sanitare)	Të drejtën për ujë të pijshëm të sigurt, kanalizime dhe një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.	Qasja në ujë të sigurt dhe mbrojtja e ekosistemeve janë themelore për bujqësinë, sigurinë ushqimore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
Gratë rurale (Neni 4)	Të drejtën për barazi, mundësi të barabarta dhe pjesëmarrje në jetën ekonomike e shoqërore.	Barazia gjinore forcon familjet, fermat dhe ekonominë rurale.
Të rinjtë ruralë Neni 3 - barazia dhe mosdiskriminimi; Neni 13 - puna; Neni 22 - mbrojtja sociale; Neni 23 - shëndeti	Të drejtën e të rinjve në zonat rurale për të gëzuar, pa diskriminim, të drejtat për punë të denjë, mbrojtje sociale dhe mundësi zhvillimi.	Investimi te të rinjtë krijon kushte që ata të ndërtojnë të ardhmen e tyre në zonat rurale dhe nxit ripërtëritjen ndërbrezore në bujqësi.
Njohuritë tradicionale (Neni 20 - biodiversiteti dhe njohuritë tradicionale; Neni 26 - të drejta kulturore)	Të drejtën për të ruajtur, mbrojtur, zhvilluar dhe transmetuar njohuritë tradicionale, praktikat dhe trashëgiminë kulturore.	Njohuritë tradicionale mbështesin biodiversitetin dhe rrisin aftësinë përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike.
Mbrojtja sociale dhe puna e denjë (Nenet 13, 22 dhe 23)	Të drejtën e punëtorëve ruralë për punë të denjë dhe mbrojtje sociale.	Siguria ekonomike i bën komunitetet rurale më të qëndrueshme dhe më rezistente

Shënim: Referencat ndaj neneve janë orientuese dhe pasqyrojnë dispozitat kryesore të UNDROP për secilën temë.

Të drejtat e njohura nga UNDROP janë të ndërlidhura dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Siguria mbi të drejtat e tokës, pjesëmarrja në vendimmarrje, barazia gjinore, mundësitë për të rinjtë, mbrojtja e mjedisit dhe puna e denjë janë elementë që, së bashku, kontribuojnë në ndërtimin e komuniteteve rurale më të forta dhe më të qëndrueshme.

Për Shqipërinë, të gjitha të drejtat e njohura nga UNDROP ofrojnë një kornizë të përbashkët që komplementojnë përpjekjet e vendit për forcimin e bujqësisë familjare, përmirësimin e qeverisjes së tokës bujqësore dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm rural.

5. Qeverisja e tokës bujqësore dhe zgjerimi i debatit kombëtar

ANRD e konsideron tokën bujqësore një burim strategjik kombëtar, mbi të cilin mbështeten siguria ushqimore, zhvillimi rural, ruajtja e komuniteteve rurale, biodiversiteti dhe qëndrueshmëria e ekonomisë bujqësore shqiptare. Mënyra se si qeveriset ky burim ndikon jo vetëm në të ardhmen e bujqësisë, por edhe në sigurinë ushqimore, zhvillimin e balancuar territorial dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural. Për këtë arsye, mënyra se si qeveriset toka bujqësore duhet të trajtohet si pjesë e një debati më të gjerë mbi zhvillimin rural dhe interesin publik.

Diskutimet e fundit mbi projektligjin për kalimin në pronësi të tokës bujqësore tek personat fizikë dhe juridikë të huaj kanë rikthyer në qendër të vëmendjes çështjen e qeverisjes së tokës bujqësore. Debati publik është përqendruar kryesisht te pyetja se kush duhet të ketë të drejtën të zotërojë tokë bujqësore. Megjithatë, qeverisja e tokës bujqësore shkon përtej çështjes së pronësisë. Ajo përfshin mënyrën se si rregullohen dhe garantohen të drejtat mbi tokën, si sigurohet akses i drejtë në burimet prodhuese, si menaxhohet toka në mënyrë të përgjegjshme dhe si krijohen kushte që ajo të vazhdojë të mbështesë bujqësinë familjare, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Ky këndvështrim nxit disa pyetje të rëndësishme që lidhen me atë se kush e punon tokën? A gëzojnë familjet fermere të drejta të sigurta dhe të njohura mbi tokën që kultivojnë? Në çmënyrë politikat për tokën forcojnë bujqësinë familjare dhe nxisin investimet afatgjata? Si mundet qeverisja e tokës të kontribuojë në zhvillimin e komuniteteve rurale më të qëndrueshme dhe më rezistente?

Siguria e të drejtave mbi tokën dhe perspektiva e UNDROP

Më shumë se tre dekada pas reformës agrare, Shqipëria vijon të përballet me sfida që lidhen me regjistrimin e tokës, sigurinë juridike dhe fragmentarizimin e tokës bujqësore. Këto sfidandikojnë negativisht në gatishmërinë e fermerëve për të investuar, kufizojnë aksesin në financim, vështirësojnë konsolidimin e tokës dhe pengojnë ripërtëritjen brezore në bujqësi. Si rrjedhim, siguria mbi të drejtat e tokës është një parakusht themelor për rritjen e konkurrueshmërisë së bujqësisë, nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës dhe krijimin e kushteve për zhvillim afatgjatë të zonave rurale.

UNDROP nuk përcakton mënyrën se si vendet, përfshi Shqipërinë duhet të rregullojë pronësinë mbi tokën bujqësore. Këto janë vendime që u takojnë institucioneve kombëtare. Vlera e Deklaratës qëndron në faktin se ajo promovon një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj qeverisjes së tokës, e cila ndërthur sigurinë e të drejtave mbi tokën, aksesin e drejtë në burimet prodhuese, menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore dhe pjesëmarrjen aktive të komuniteteve rurale në vendimmarrje. Në këtë mënyrë, UNDROP plotëson reformat që Shqipëria po ndërmerr, duke vendosur në qendër të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural njerëzit që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale.

Nga perspektiva e ANRD-së, toka bujqësore është baza e bujqësisë familjare, e mirëqenies së komuniteteve rurale, e sigurisë ushqimore dhe e zhvillimit të qëndrueshëm të territoreve rurale. Për këtë arsye, debati mbi tokën bujqësore nuk duhet të kufizohet vetëm te çështja e pronësisë. Ai duhet të përfshijë edhe kushtet që u mundësojnë familjeve fermere të investojnë, të gjejnë zgjidhje të reja, dhe të vazhdojnë të jetojnë e të punojnë në tokën e tyre. Siguria mbi të drejtat e tokës, përmirësimi i qeverisjes së saj dhe mbështetja e bujqësisë familjare janë objektiva që plotësojnë njëra-tjetrën dhe kontribuojnë në arritjen e objektivave që synojnë një sektor bujqësor më konkurrues, më të qëndrueshëm dhe më rezistent.

Debati aktual krijon një mundësi për të diskutuar jo vetëm kush mund të zotërojë tokë bujqësore, por edhe si mund të shërbejë toka bujqësore më mirë interesit publik dhe zhvillimit afatgjatë të Shqipërisë rurale. ANRD mbështet premisën se qeverisja e mirë e tokës bujqësore nuk matet vetëm me atë se kush mund ta zotërojë tokën, por edhe me aftësinë e politikave për të mbështetur bujqësinë familjare, për të mbrojtur tokën prodhuese dhe për të garantuar një të ardhme të qëndrueshme për komunitetet rurale.

6. Drejt një dialogu të përbashkët

Për Shqipërinë, shumë prej parimeve të Deklaratës janë tashmë në përputhje me prioritetet kombëtare dhe reformat në zhvillim. Prezantimi i UNDROP synon të nxisë dialogun dhe reflektimin mbi mënyrën se si parimet e Deklaratës mund të mbështesin përpjekjet për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Vlera e veçantë qëndron në nxitjen e një qasjeje më të gjerë ndaj zhvillimit rural, me qëndër njerëzit në territor krahas prodhimit bujqësor. Përkthimi i këtyre parimeve në praktikë është një përgjegjësi e përbashkët që kërkon bashkëpunimin e institucioneve publike, pushtetit vendor, organizatave të fermerëve, shoqërisë civile, komunitetit akademik dhe partnerëve të zhvillimit.

Në këtë proces, institucionet publike kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave që mbështesin bujqësinë familjare, zhvillimin rural gjithëpërfshirës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Pushteti vendor, organizatat e fermerëve dhe shoqëria civile duhet të forcojnë kontributin e tyre përmes rritjes së pjesëmarrjes së komuniteteve rurale, duke lehtësuar dialogun dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet aktorëve lokalë. Po aq i rëndësishëm është edhe kontributi i universiteteve dhe institucioneve kërkimore, të cilat duhet të ndihmojnë politikëbërjen me njohuri, kërkime dhe evidencë, si edhe i partnerëve ndërkombëtarë, përmes mbështetjes së nismave që promovojnë zhvillimin rural të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Në fund të fundit, zhvillimi i qëndrueshëm rural nuk varet vetëm nga rritja e prodhimit bujqësor, por edhe nga krijimi i kushteve që njerëzit që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale të kenë mundësi të kontribuojnë, të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të ndërtojnë një të ardhme më të mirë për komunitetet e tyre.

7. Referencat

La Via Campesina. (2024). Fact Sheet on the UN Working Group on the Rights of Peasants and Other People Working in Rural Areas (UNDROP). Aksesuar në: https://defendingpeasantsrights.org/wp-content/uploads/2024/04/web-english_revised-Factsheet_sd-1.pdf

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2022). Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027. (DCM Nr. 460, datë 29.6.2022). Aksesuar në: <https://bujqesia.gov.al/strategji-2/>

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) & Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD). (2019). United Nations Decade of Family Farming 2019 - 2028: Global Action Plan. Aksesuar në: <https://www.fao.org/family-farming/detail/en/c/1195619/>

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural. (2026). Deklarata e Përbashkët e Parlamentit IV Rural Shqiptar: Shqipëria rurale në rrugën drejt Bashkimit Evropian përmes partneriteteve, reformave dhe zhvillimit koheziv territorial. Aksesuar në: <https://anrd.al/publikime/deklarata-e-perbashket-e-parlamentit-iv-rural-shqiptar-2026/>

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD). (2026). Qëndrim Publik mbi projektligjin “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore tek personat fizikë dhe juridikë të huaj”. Aksesuar në: <https://anrd.al/publikime/qendrim-publik-mbi-projektligjin-per-kalimin-ne-pronesi-te-tokes-bujqesore-tek-personat-fizike-dhe-jur-dike-te-huaj-ne-kontekstin-e-zhvillimit-rural-dhe-integrimet-evropian/>

United Nations General Assembly. (2018). United Nations Declaration on the Rights of Peasants and Other People Working in Rural Areas (UNDROP). Resolution A/RES/73/165. Aksesuar në: <https://docs.un.org/en/A/RES/73/165>